



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE PEJË
OSNOVNI SUD PEĆ – BASIC COURT PEJA

Duke u bazuar në Ligjin e Shërbimit Civil të Republikës së Kosovës L. NR. 03/L – 149 dhe në Rregulloren nr. 02/2011 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Gjykata Themelore në Pejë shpall këtë:

KONKURS Nr.2/2018

1. Gjykata Themelore Pejë-----Referent i Lartë-----3 (tri) pozita

GJTHPD001 - Gjykata Themelore në Pejë

Titulli i vendit të punës: Referent i Lartë

Numri i referencës: RN00002922

Niveli i pagesës: 407.55 €

Raporton tek: Udhëheqësi i Zyrës për Menaxhimin e Lendeve

Qëllimi i vendit të punës

1. Siguron dhe mbikëqyr sistemin e përcjelljes së lëndëve dhe menaxhon lëndët e ngarkuara të gjykatë si dhe mbanë mënyrë të rregullt të gjitha regjistrat e gjykatës, jep këshilla profesionale për referentet dhe harton raporte mujore. Përcjell punën e punën e referentit dhe pranon dhe regjistron lëndët e ngarkuara të gjykatës dhe të gjitha shkresat tjera.

Detyrat Kryesore

- | | | |
|----|---|-----|
| 1. | 1.Pranon dhe regjistron në regjistrin pranues të gjitha parashtrirat gjyqësore . | 20% |
| 2. | 2.Regjistron dhe mban të dhënat dhe dokumentet në regjistrat e gjykatës. | 20% |
| 3. | 3.Mbikëqyrë sistemin e përcjelljes së lëndëve, dhe menaxhon lëndët e ngarkuara të gjykatës. | 10% |
| 4. | 4.Mirëmban të dhënat e gjykatës. | 10% |
| 5. | 5.Organizon dhe mirë mban shkresat e dosjeve të lendeve në gjykatë. | 10% |
| 6. | 6.Kujdesët për udhëheqjen e lëndëve të ngarkuara në gjykatë si dhe ofron punë cilësore. | 10% |
| 7. | 7.Bën shpërndarjen e shkresave dhe lendeve tek zyrtarë e lëmis përkatëse. | 10% |
| 8. | 8.Kryen edhe punë të tjera sipas nevojës | 10% |

Shkathtësitë

1. 1.Te ketë shkathtësi të dëshmuara nder personale dhe komunikim të shkëlqyeshëm me shkrim dhe me gojë e nevojshme
2.Aftësi të rregullimit dhe ruajtjes së kujdesshme të dosjeve të lendeve- ekzekutiv-nevojshme
3. Aftësi për punë të pavarur dhe vendosje të prioriteteve- e nevojshme

Edukimi

1. Diplomë universitare fakulteti Juridik e nevojshëm

Kualifikimi

1. 1 Certifikat mbi vijimin e ndonjë trajnimi -e preferuar.
2. Njohja e kompjuterit (Word, Exel)- e nevojshme
3. Njohja e gjuhës Serbe- e preferuar

Experienca

1. Dy vite përvojë pune Juridike pas diplomimit

Rrethana të jashtëzakonshme

1. Nuk paraqet ndonjë rrezik të jashtëzakonshëm.

Niveli i përgjegjësisë financiare

1. //

Marrja dhe dorëzimi i aplikacioneve:

Gjykata Themelore Pejë. Rr. "Adem Jashari", pa nr. Për informata të hollësishme mund të kontaktoni me: Muhamet Asanaj, në tel: 433-355 ose përmes postës elektronike (Muhamet Asanaj) prej orës 8:00 -16:00. Konkursi është i hapur nga data e publikimit në gazetën ditore "Zëri" prej dt.23.03.2018 gjer me datë 06.04.2018.

[Shkarko aplikacionin](#)

Aplikacionit duhet ti bashkëngjiten kopjet e dokumentacionit si në vijim: 1. Dëshmit mbi kualifikimin shkollor (kopja e diplomës), 2. Dëshmit mbi përvojën e punës, 3. Dokumentin e identifikimit (përfshirë edhe certifikatën e lindjes), 4. Çertifikimet e ndryshme, 5. Çertifikatat që nuk është nën hetime. 6. Dy rekomandime 7. Çdo dokument tjetër të kërkuar sipas konkursit apo që ju mendoni që është relevant për konkurrimin tuaj.

Aplikimi: Kërkesa (Aplikacioni) për punësim gjendet në Web portal: <http://www.gjyqesori-rks.org>.

Aplikacionet e dërguara me postë (kodi postar 30000), të cilat mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim, do të konsiderohen të vlefshme dhe do të merren në shqyrtim, nëse arrijnë brenda 4 ditësh, aplikacionet që arrijnë pas këtij afati dhe ato të pakompletuara nuk do të shqyrtohen fare.

Aplikacionit i bashkëngjiten kopjet e dokumentacionit mbi kualifikimin, përvojën dhe dokumentacionet e tjera të nevojshme, që kërkohen për atë vend pune, për të cilin konkurroni.

Të drejtë konkurrimi kanë të gjithë banorët e Kosovës prej moshës 18-64 vjeçare. Aplikacionet duhet të plotësohen qartë dhe lexueshëm. Në aplikacion duhet të shënohen të gjitha të dhënat e kërkuara. Duhet të përcaktohet saktësisht vendi dhe pozita për të cilën aplikon.

Nëse aplikacionit nuk ia bashkëngjitni dokumentet e duhura dhe nuk e plotësoni atë me shënime të sakta, ju vetë do ta humbni rastin për t'u futur në listën e ngushtë.

Informimi i kandidatëve do të bëhet përmes telefonit, e-mail adresës ,ose përmes Web portalit <http://www.gjyqesori-rks.org>

- Fotokopjet e dokumenteve të bashkëngjitura në aplikacion kandidatët nuk kanë të drejtë ti tërheqin prapa.

Kandidatët të cilën hyjnë në përzgjedhje të listës së ngushtë për intervistë do të informohen me telefon, në afat ligjor.

Shërbimi civil i Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë.